



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM  
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*Data: 21.04.2022*

**Drejtuar:** “FUSHA” sh.p.k, me NUIS J61922018S , me adresë: Njesia Bashkiake nr 2, Rruga Murat Toptani, perballe Kinema Milenium, godina nr.3, Pedonalja , Tiranë.

\* \* \*

**Procedura e prokurimit:** E hapur e thjeshtuar, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 12 mujor

**Numri i procedurës / referenca e Lotit:** REF-23281-03-28-2022

**Përshkrimi i shkurtër i kontratës:** “Shpenzime për mirëmbajtjen e objekteve specifike”, me afat lëvrimi nga lidhja e kontratës /kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor sipas kërkesës, në bazë të marrëveshjes kuadër, me fond limit: 4.582.750 (katër milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

**Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet):**Buletini i Njoftimeve Publike Datë 04.04.2022, Numri 43

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të kësaj bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

1. Operatori ekonomik "FUSHA" sh.p.k, me NUIS J61922018S, me vlerë të ofruar prej 4.399.400 (katër milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik "SHANSI INVEST" sh.p.k, me NUIS J61924002T, me vlerë të ofruar prej 4.578.600 (katër milion e pesëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomikë e mëposhtëm:

### **1. Operatori Ekonomik "SHANSI INVEST" sh.p.k, me NUIS J61924002T**

*Arsyet e skualifikimit janë:*

1. Nuk përmbush pikën 2.3.1 të kapacitetit teknik ku parashikohet se: *"Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate. Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

*a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,*

*b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara."*

pasi kontratat e paraqitura nga operatori ekonomik nuk janë të ngjashme me objektin e prokurimit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm është identifikuar si i suksesshëm:

1. Operatori ekonomik "FUSHA" sh.p.k, me NUIS J61922018S, me vlerë të ofruar prej 4.399.400 (katër milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".